

REGJISTRIMI I STUDENTIT NË STUDION E DIPLOMËS 2021-2022

DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS

Për vitin akademik 2021-2022, të gjithë studentët që planifikojnë të frekuentojnë studion e diplomës duhet të regjistrohen paraprakisht në njërin prej 4 atelieve të ngritura nga Departamenti i Arkitekturës.

Studentët duhet të njihen me fushat e kërkimit që ofron secila atelie dhe të shprehin interesin e tyre për të propozuar tema diplome që përputhen me këto fusha.

Në bazë të këtij kriteri, studentët do të shprehin preferencat e tyre duke i renditur atelietë nga zgjedhja e parë (më e preferuar), deri tek zgjedhja e fundit.

Preferencat do të dërgohen me *e-mail* në adresën studiodiplome22@yahoo.com në formatin e mëposhtëm:

Emri Mbiemri

Atelietë e diplomës	Preferenca e studentit (shënoni nga 1 ne 4)
Atelie a	
Atelie b	
Atelie c	
Atelie d	

Aplikimet nisin në datë 5 Nëntor 2021 në orën 12.00 në mesditë dhe mbyllen pas 48 orësh (data 7 Nëntor).

Vini re: Aplikimet që mbërrijnë përpara orës 12.00 nuk do të konsiderohen të vlefshme!

Sipas rendit kronologjik të mbërritjes së aplikimeve me *e-mail*, do të përmbushen edhe preferencat e studentëve për përfshirjen në atelietë e përzgjedhura. (*e-maili* i mbërritur i pari ka të drejtë të bëjë zgjedhjen e parë)

Studentët që nuk arrijnë të aplikojnë përmes *e-mailit* do të regjistrohen pa marrë parasysh preferencën e tyre mbi fushën apo atelienë.

Brenda datës 08 nëntor 2021, Departamenti do të shpallë shpërndarjen e studentëve në atelietë e mësipërme.

Pas regjistrimit në atelie, **studenti** do të përgatisë dhe të dorëzojë në Departament propozimin për temën e diplomës dhe udhëheqësin në përputhje me fushat të cilat mbulon atelieja ku do të ndjekë diplomën.

Verifikimi i plotësimit të kushteve për frekuentimin e diplomës do të bëhet nga sekretaria në fund të semestrit të parë. Studentët që rezultojnë se nuk përmbushin këto kushte nuk do të mund të vijojnë frekuentimin dhe shlyerjen e kontrolleve të semestrit të dytë në atelietë përkatëse.

PERSHKRIMI I ATELIEVE TE DIPLOMËS

ATELIE A	ATELIE B	ATELIE C	ATELIE D
Drejtues i grupit L.CAPELI	Drejtues i grupit A.MALIQARI	Drejtues i grupit D.VEIZAJ	Drejtues i grupit F.NEPRAVISHTA
Fusha orientuese	Fusha orientuese	Fusha orientuese	Fusha orientuese
<i>Studime mbi arkitekturën dhe arkitektët modernë në Shqipëri.</i> <i>Vendet për kulturën dhe spektaklin</i>	<i>Arkitektura e konfliktit</i>	<i>Memoria kolektive. Analize kritike ne leximin e qytetit Identitete dhe kufij</i>	<i>Arkitektura dhe Rijetëzimi i Ndërtesave dhe i Ansambleve Arkitektonike</i>

<i>"Housing", sfidat e reja te problemeve te ardhshme te banimit në vendin tone.</i>	<i>Modele të qëndrueshme të arkitekturës</i>	<i>Arkitektura e lëvizjes</i>	<i>Arkitektura Shekullit të XX në Shqipëri</i>
<i>Rrugët për zhvillimin e strukturave turistike ne realitetin shqiptar dhe rajonal:</i>			<i>Projektimi i Qëndrueshëm dhe Rindërtimi ne rast te fatkeqësive natyrore</i>
			<i>Projektimi i banesave</i>

ATELIE A

L.CAPELI

STUDIME MBI ARKITEKTURËN DHE ARKITEKTËT MODERNË NË SHQIPËRI.

Arkitektura moderne në Shqipëri ka kaluar tashmë 100 vite histori, një histori jo e shkruar e cila për tu njohur e trajtuar gjerësisht me të gjitha anët pozitive e negative të saj, duhet studiuar. Qytetet tona nisën modernizimin e tyre me plane urbanë të propozuar nga arkitektë të huaj por shpesh edhe në bashkëpunim me arkitektë shqiptarë. Pjesërisht të aplikuar apo jo, këto plane u bënë sfondi për të ndërtuar veprat e mëvonshme arkitektonike, kryesisht të karakterit privat të tipologjisë së banimit, por edhe të karakterit publik të tipologjive të ndryshme administrative. Në dekadat para çlirimit këto vepra u ndërtuan nga arkitektë të huaj e shqiptarë, ndërkohë që pas çlirimit e deri në vitet '90 çdo objekt u projektua nga arkitektë shqiptarë, fillimisht ndoshta edhe në bashkëpunim me të huaj, por më pas në pavarësi të plotë projektuese. Kemi kështu një gamë të gjërë ndërtimesh të bëra nga arkitektë më shumë apo më pak të njohur, të cilët kanë shënuar mes krijimtarisë së tyre historinë e arkitekturës sonë moderne.

Kjo atelie Diplome ka për qëllim të nxisë studimin e këtyre veprave, ti evidentojë të grupuara në tipologji por edhe të hulumtojë mbi zhvillimin e tyre formal, funksional e stilistik. Këto studime tipologjike duhen parë në kuadrin lokal të zhvillimit arkitektonik të ndërtimeve në Shqipëri por edhe në analizë krahasuese me të njëjtat tipologji të njëkohshme në botë, për të bërë të mundur kështu evidentimin nëse ai ekziston apo jo, të një karakteri lokal arkitektonik të influencuar nga faktorë të brendshëm socio-politikë apo ekonomikë.

Nga ana tjetër Studime të karakterit hulumtues, përshkruar e analizues, mund të përfshijnë aktivitetet krijuese projektuese të arkitektëve Shqiptarë të periudhës së modernizmit në Shqipëri, duke evidentuar kronologjikisht objektet e projektuar, materialet grafike e fotografike të tyre, e nëpërmjet analizës formale e stilistike të deduktohet mbi aktivitetin krijues të arkitektit për të konkluduar në një biografi arkitektonike të tij.

VËNDËT PËR KULTURËN DHE SPEKTAKLIN

Kjo studio diplome propozon një udhëtim ndërmjet reales dhe sureales nëpërmjet realizimit të veprës arkitektonike të dedikuar kulturës dhe spektaklit, si ndërmjetës me rol sublim në emancipimin e shoqërisë metropolitane. Strukturat arkitektonike shihen si një suport i rëndësishëm për rritjen e kualitetit të jetës nëpërmjet trajtimit të nevojës për rekreacion e cila në zhvillimet më të fundme, merr një rëndësi të veçantë në konsolidimin e shoqërisë nëpërmjet mendimit artistik. Guy Debord në librin e tij – Shoqëria e Spektaklit, shprehet: “spektakli nuk është vetëm një bashkësi imazhesh, por një raport social personash i ndërmjetësuar nëpërmjet imazhesh.” Që prej lashtësisë e përgjatë gjithë historisë së arkitekturës perëndimore, është konsideruar si esencial roli emancipues e filtrues i hapësirës arkitektonike e cila ka potencialin për të ndryshuar sjellje e vizione shoqërore. Kjo fuqi e rrallë, jo vetëm imazhistike, por e një dimensionit më të gjerë konceptual, gjendet e ngurtësuar brenda materies së ndërtesave të cilat i dedikohen kulturës dhe spektaklit. Në ato shpesh kondensohet vetë shpirti i epokës dhe esenca e shoqërisë e cila animon hapësirën dhe i jep vitalitet formës statike arkitektonike. Në këtë këndvështrim produkti duhet ti përgjigjet në mënyrë të denjë tendencës, por njëkohësisht duhet të suportojë peshën e një shprehje formale sublime, pa kohe dhe të përshtatshme ndaj ndryshimeve frenetike që hasen sot në shoqërinë bashkëkohore.

Konkretisht, pjese e kesaj studio diplome do të jenë tema të cilat trajtojnë objekte që lidhen me kulturën dhe artin duke mos u kufizuar por, duke përfshirë gamën më të gjerë të tyre. Në këtë kuptim do të trajtohen tipe me tradicionale të shprehjes kulturore si teatro, opera, muze, biblioteka, shkolla arti dhe muzike, ashtu sikur edhe tendenca të mëvonshme të objekteve më eksperimentale, të cilat shkojnë drejt një përzierje më komplekse programatike siç mund të jenë qendrat kulturore multidisiplinore.

Studenti do të përshkojë një itinerar projekti që kalon përmes analizës së qytetit deri në përcaktimin e kontekstit të duhur të ndërhyrjes, studime që lidhen me tendencën dhe frymën e zhvillimeve kulturore dhe arkitektonike bashkëkohore, për të kaluar më pas në formulimin e zgjidhjes dhe deri detajimin e propozimit arkitektonik.

"HOUSING", SFIDAT E REJA TE PROBLEMEVE TE ARDHSHME TE BANIMIT NË VENDIN TONË.

Në përputhje me ecurinë e pamatshme të zhvillimit të qyteteve dhe sidomos ndërtimeve të banimit (banesat) del urgjente që në pikëpamje studimore të krijohet një tablo e zhvillimeve sasiore, zhvillimeve hapësinore në territorin brenda dhe jashtë qyteteve në vendin tonë, zhvillimeve tipologjike dhe morfologjike që mbizotërojnë, dhe kanë perspektive zhvillimi për vitet që vijnë.

Temat e diplomave, qofshin studimore po ashtu dhe projektuese duhet të kenë në fokus evidentimin e fenomenit "Housing" në Shqipëri me të mirat dhe të këqijat e tij, veçoritë në përsëritjen e rrugëve të njohura botërore, si dhe veçoritë në bumin e banesave në realitetin kaotik shqiptar.

Për efekt të studimit dhe klasifikimit mendojmë se është e nevojshme të orientohet studimi në grupe morfologjike si dhe në forma përhapjeje në strukturën e qytetit (qendër-periferi):

- a) Zhvillimet e banimit shumëkatësh, aktualitete, tendenca dhe kufizimet në realitetin tonë të ardhshëm.
- b) Zhvillimet e baneve të ulëta (low rise housing), fillesat dhe kushtet e ardhshme për zhvillim
- c) Programet funksionale dhe ekonomike të banesave popullore si dhe banesave me kushte të avancuara ekonomike.
- d) Zhvillimet e fenomenit "Housing" në reflektimin drejt banesave me përdorim miks (përdorim banimi dhe përdorim publik) si formë eksperimentale dhe bashkëkohore në zhvillimet brenda qyteteve sot.
- e) Kërkimi për gjetjen e rrugëve të identifikimit lingistik arkitekturor në banesat në zonat e ndryshme klimatike (bregdetare, kodrinore, malore)
- f) Reflektimi i kërkesave të shtetshëmbësirës ambientale në zhvillimet e banimit në të ardhmen.
- g) Roli i ndërtimeve informale në strukturat e banimit urban, gjetja e rrugëve për formalizmin në të ardhmen, problem themelor i habitatit kombëtar.

Tematikat e kërkuara siç shikohen trajtohen në kushtet kur akoma nuk kemi konkluzione paraprake për problemin "Housing" në rang kombëtar.

Kjo është edhe arsyeja që në tematikat e mësipërme nuk përjashtohen por presupozohen të studiohen në sintezë me sa më sipër dhe problemet në këndvështrimin e politikave shtetërore, financiare e legjislativë, planifikuese urbane, duke e parë zhvillimin e arkitekturës së "Housing" të pa shkëputur nga këta faktorë.

RRUGËT PËR ZHVILLIMIN E STRUKTURAVE TURISTIKE NE REALITETIN SHQIPTAR DHE RAJONAL:

Zhvillimet turistike kërkojnë urgjentisht një kapje të problematikës urbane dhe arkitektonike nëpërmjet studimeve dhe projekteve eksperimentale në kohën e zhvillimit tranzitor dhe në hapësirën rajonale ku jetojmë duke kuptuar se me aq sa kemi ndërtuar në jemi futur në procesin e zhvillimeve të ambientit të ndërtuar, të natyrës turistike me prishje dhe pak harmoni me natyrën dhe historinë.

Temat e diplomave duhet të analizojnë shkallën e zhvillimit ndërtimor, shkallën e ndërhyrjes në mjedis, problematikën menaxhuese dhe administruese në kushtet e një ekonomie private liberale por dhe të kontrolluar.

Mendojmë se tematikat mund të grupohen si më poshtë:

Zhvillimet e ndërtimeve turistike në pikëpamjen sasiore, impakti aktual dhe perspektiv- ekonomik, format legjislativë dhe financiare në stimulimin e programeve të mëdha kombëtare dhe lokale. Kjo tematikë nuk duhet të bjerë në rutinën e analizave social-ekonomike pa u ndërthurur me tematikën e identifikimit të strukturave ndërtimore dhe arkitektonike me efekt pozitiv dhe negativë në ambient.

Gjetja e formave të strukturave turistike në përputhje me madhësinë dhe veçorinë e qyteteve, vendbanimeve, dhe pikave turistike me rëndësi kombëtare dhe lokale.

Orientimi dhe zhvillimi i strukturave urbane të vetë-zhvilluara në funksion të turizmit, bregdetar dhe malor. Faktorët gjenerues, shtytës dhe orientues në një proces të tillë të planifikimit të urbanizmit vetë veprues, arkitekturës vernakulare.

Dokument orientues per studentet e programit te studimit MSHA-Profil Arkitekt
DEPARTAMENTI I ARKITEKTURES
NENTOR 2021

Analizat e zhvillimeve konceptuale për gjetjen e veçorive dhe identiteteve linguistike të strukturave turistike formale dhe informale në kushtet kombëtare dhe mesdhetare.

Kërkimet në gjetjen e strukturave dhe teknologjive ndërtimore që lidhen me traditën dhe e modernizojnë atë.

Analizat e zhvillimit të fenomenit turistik në të gjitha fazat duhet të bashkë-shoqërohen ngushtësisht me analizat e ruajtjes dhe zhvillimit të mjedisit.

Tematikat studimore dhe projektuese duhet të përcaktojnë mirë faktorët e qëndrueshëm natyror dhe urban ekzistues të cilat janë faktorë të përhershëm gjenerimi dhe përcaktojnë mundësitë e zhvillimit në të ardhmen.

Orientimi problematik i mësipërm nuk duhet të pengojë imagjinimin e projekteve dhe studimeve që zhvillojnë si strukturat turistike popullore të rekreacionit masiv, pa përjashtuar strukturat elitare turistike si hotelet, resortet, fshatrat turistike etj.

ATELIE B

A.MALIQARI

ARKITEKTURA E KONFLIKTIT

Arkitektura mbetet dëshmia më e dukshme e zhvillimit të një shoqërie. Qytetet, si forma më komplekse e ambientit të ndërtuar nga njeriu, janë organizma ku mbivendosen shtresat historike e arkitektonike të periudhave të ndryshme dhe ku konflikti mes të shkuarës e të tashmes mbetet thelbi i zhvillimit të fenomeneve urbane.

Pikërisht në këtë luftë të vazhdueshme në organizmin urban shtrihet fusha e kërkimit të kësaj studioje diplome ku objektivi kryesor lidhet me konfliktin në arkitekturë, si një fenomen që gjeneron identitetin e qyteteve të së nesërme.

Konflikti në arkitekturë duhet kuptuar si nevoja për të dominuar përmes formës së ndërtuar dhe kjo nevojë shfaqet dukshëm në momente kyçe historike të tranzicionit politik, ideologjik apo ekonomik të një vendi. Nevoja për të konfirmuar të ardhmen mbi të shkuarën krijon tensionin dhe konfliktin urban, ku arkitektura shndërrohet në mjet për të shpërfaqur forcën e vizionin dhe njëkohësisht për të ushqyer propagandën.

Që prej themelimit të shtetit shqiptar, arkitektura nuk ka mundur për asnjë çast të shkëputet nga konflikti, duke qenë gjithmonë gjenerues dinamikash apo debatesh të mprehta të cilat prodhojnë mjedise urbane të pazakonta me impulse të larta zhvillimi. Pikërisht në përballje me të shkuarën dhe të tashmën, kërkimi do të tentojë të evidentojë apo të gjenerojë trajta të bashkekzistencës të arkitekturës apo hapësirës publike. Në këtë kontekst, **marrëdhënia me qytetin historik dhe trashëgiminë, qytetin socialist dhe ideologjinë si dhe dinamikën e sotme politike dhe ekonomike të zhvillimit do të jenë gjeneruesit e tematikave të projekteve dhe kërkimit** që do të zhvillohen nga diplomantët. Konflikti do të jetë baza e diskutimit përmes të cilit propozimet e diplomantëve do të përballen me qytetin me qasje që shtrihen **mes sfidës dhe utopisë**.

Tema specifike për tu zhvilluar përmes projektit dhe / apo kërkimit të diplomës mund të fokusohen në:

1. *Propozime të reja arkitektonike të vendosura në kontekste historike.*
2. *Ndërhyrje arkitektonike apo urbane në ndërtesa dhe hapësira publike ekzistuese.*
3. *Propozime për simbole të reja urbane.*
4. *Retushimi i imazhit të qytetit.*

MODELE TË QËNDRUESHME TË ARKITEKTURËS

Zhvillimi i qëndrueshëm mundëson përmbushjen e nevojave për gjeneratat e sotme, pa privuar gjeneratat e ardhshme nga e njëjta e drejtë. Thelbësore për këtë koncept, është ruajtja e balanceve dhe sistemeve natyrore mbi të cilat varen ekonomia dhe shoqëria.

Në këtë kuadër, arkitektura dhe qytetet janë ndër faktorët bazë që duhet të ri-dimensionojnë modelin e ofruar. Eksperienca e deritanishme vlerësohet si një model i dështuar i cili ka nevojë emergjente për tu ri-konceptuar në kërkim të qasjeve me ndjeshmëri të lartë kundrejt habitatit.

Mbështetur në frymën e “Axeve të Re Urbane - Deklarata e Kuito-s mbi qytete të qëndrueshme dhe vendbanimet për të gjithë” (<http://habitat3.org/wp-content/uploads/NUA-Albanian.pdf>) të Kombeve të Bashkuara (UN Habitat III, 2016), kërkimi mbi **modele të reja të qëndrueshme zhvillimi nga shkalla arkitektonike e deri në atë të vendbanimeve dhe territorit** mbetet një sfidë sa globale po aq e lidhur ngushtë me kontekstet specifike lokale. Janë pikërisht këto modele zhvillimi, të reja e të përgjegjshme kundrejt kontekstit dhe sfidave të së ardhmes, që synojnë të jenë thelbi i kërkimit të studios së diplomës.

Kërkimi do të mbështetet në vizionin e qyteteve për të gjithë, duke iu referuar përdorimit të barabartë dhe të qëndrueshëm të qyteteve dhe vendbanimeve, duke synuar të promovojë përfshirjen dhe duke siguruar që të gjithë banorët e brezave të sotëm dhe të ardhshëm, pa asnjë lloj diskriminimi, të jenë në gjendje të jetojnë dhe të krijojnë qytete dhe vendbanime të përshtatshme, të sigurta, të shëndetshme, të arritshme, rezistente, dhe të qëndrueshme, si një e mirë e përbashkët që në thelb kontribuon për prosperitetin dhe cilësinë e jetës për të gjithë.

Dokument orientues per studentet e programit te studimit MSHA-Profil Arkitekt
DEPARTAMENTI I ARKITEKTURES
NENTOR 2021

Në kërkimin arkitektonik synimi është për të zhvilluar modele ndërtimi dhe ndërtesa të qëndrueshme, të rinovueshme, ndërtime dhe mënyra ndërtimi me energji eficiente e që kontribuojnë në mirëqenie dhe në përmirësimin e shëndetit publik.

Përmes projekteve apo kërkimit diplomantët do të inkurajohen të propozojnë modele arkitektonike e urbane të qëndrueshme, ku fokusi përtej dimensionit ambiental, do të jetë në modelin social, kulturor dhe ekonomik.

Tema specifike për tu zhvilluar përmes projektit dhe / apo kërkimit të diplomës mund të fokusohen në:

1. *Modele jetese, urbane e ndërtimi duke iu referuar parimeve të qëndrueshmërisë ambientale. Studenti mund të zhvillojë kërkim metodologjik me fokus në parimet e qëndrueshmërisë për të prodhuar modele inovative ndërtesash apo të hapësirës urbane.*
2. *Ndërtesa të qëndrueshme, të cilat përdorin sisteme e teknologji pasive dhe burime energjie të rinovueshme. Studenti mund të fokusohet në projektimin e ndërtesave të reja apo rehabilitimin e atyre ekzistuese ku qëllim parësor mbetet performanca ambientale e ndërtesës.*
3. *Mënyra ndërtimi dhe qasje projektuese, që kontribuojnë në mirëqenie, me kosto sa më të ulët ndërtimi dhe / apo shfrytëzimi të objekteve. Studenti mund të fokusohet në teknikën e materialeve, ciklin e jetës dhe përdorimin / ripërdorimin e tyre si dhe në teknologjitë e aplikuara në ndërtesat me eficientë energjie.*
4. *Ndërtesa me kompleksitet të lartë të skemës funksionale dhe teknologjike. Studenti mund të fokusohet në impaktin ambiental dhe marrëdhënien me mjedisin natyror dhe / apo kontekstin urban.*

ATELIE C

D.VEIZAJ

MEMORIA KOLEKTIVE. ANALIZE KRITIKE NE LEXIMIN E QYTETIT IDENTITETE DHE KUFIJ

Shprehjet e transformimeve kulturore në mjedisin fizik të ndërtuar (duke iu referuar qasjes së *Deleuze*) mbeten një temë komplekse e cila gërsheton elemente të lidhura me memorien kolektive si konstrukt social, me identitetin hapësinor apo me atë metaforik të kufirit. Ndërkohë N. Ellin, në një qasje mbi post-modernizmin e rendit kufirin si metaforën pasardhëse, pas asaj të kolazhit, mbi të cilën lexohen qytetet bashkëkohore si realitetet fizike e të

paprekshme në të njëjtën kohe. Objekti i kësaj studioje është të kthehet në një ftese për kërkuesin e studentin diplomant njëkohësisht, të eksplorojë kontekstin shqiptar, si një realitet i ndërtuar *mes kufijsh*, përmes optikës së identitetit e memories.

Përmes propozimeve më specifike që diplomanti do të sjellë, synohet përballja me *sub-tema* me konkrete, si kontributi i shkallës hapësinore në identitet, refleksione mbi marrëdhënien e tipologjisë arkitektonike e kontekstit, apo pasqyrime të *lifestyle-it* në mjedisin fizik të ndërtuar etj.

Mjeti eksplorues i fushës mbetet fleksibël, që nga projekti arkitektonik si sublimim i një procesi kompleks krijues, deri tek *të shkruarit*, si forma me ortodokse e kërkimit teorik.

ARKITEKTURA PËR LËVIZJEN

Kjo fushë tenton të përfshijë departamentin si njësi kërkimore në çështje me kontekstuale, ku strategjia mbi lëvizjen e transportit ka marrë një peshe specifike në realitetin shqiptar, si një vend në transformim te vazhduar.

Synimi i ateliesë së diplomës, tenton të ezaurojë në shkallë arkitektonike problematiken e hedhur nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar si dhe strategji sektoriale lidhur me fushën.

Objekti i ateliesë tenton thellimin teorik mbi çfarë tipologjitë arkitektonike lidhur me lëvizjen e transportin përfaqësojnë për qytetin bashkëkohor dhe për profilin e individit bashkëkohor. Përmes propozimeve me konkrete të diplomanteve e konsulentëve, synohen thellime mbi tema me specifike si evoluimi tipologjik dhe roli i teknologjive digjitale në këtë proces, roli i dizajnit arkitektonik në trajtimin e gjurmëve infrastrukturore në territor (raporti i këtyre objekteve me qytetin, dialog apo dominim?).

Mjeti eksplorues i fushës mbetet fleksibël, që nga projekti arkitektonik si sublimim i një procesi kompleks krijues, deri tek *të shkruarit*, si forma me ortodokse e kërkimit teorik.

ATELIE D

F.NEPRAVISHTA

ARKITEKTURA DHE RIJETËZIMI I NDËRTESAVE DHE I ANSAMBLEVE ARKITEKTONIKE

Atelieja e Diplomës synon të trajtojë çështjen e rijetëzimit dhe rigjenerimit të trashëgimisë ekzistuese të ndërtesës, një nga çështjet më të rëndësishme në panoramën e arkitekturës bashkëkohore, veçanërisht në lidhje me kontekstin Shqiptar.

Atelieja e Diplomës dëshiron të veprojë kryesisht si një mundësi për reflektim pjesëmarrës dhe shume disiplinor - duke pasur si qëllim ne vetvete projektin e arkitekturës - për te projektuar përmes përcaktimit të një kornize kritike metodologjike, brenda së cilës studenti mund të identifikojë një strategji të pjekur dhe aktuale që synon rijetëzimit e ndërtesave ekzistuese dhe i ansambleve arkitektonike te degraduara.

Atelieja e Diplomës do të adresojë çështjen e përgjithshme të rimëkëmbjes së ekzistueses në Arkitekturë, si brenda traditës Shqiptare të ndërtimit të orientuar historikisht drejt ripërdorimit, ashtu edhe në lidhje me prirjet më të përparuara të arkitekturës bashkëkohore që kushtojnë një vëmendje e veçantë temës te riciklimit krijues dhe dialektikës midis arkitekturës ekzistuese dhe asaj të re. Në veçanti, atelieja do t'i drejtojë studentët të reflektojnë mbi implikimet arkitektonike të një game te gjere objktesh dhe situatash urbane te trashëgimisë sonë te ndërtimit. Atelieja do t'i drejtojë studentët të reflektojnë mbi implikimet arkitektonike të një projekti rijetëzimi në drejtim të përdorueshmërisë, qëndrueshmërisë teknike dhe formale, komfortin, zhvillimit të qëndrueshëm dhe ruajtjes se ambientit për të zhvilluar aftësi në lidhje me një temë që do të përbëjë një mundësi të rëndësishme pune projektimi për një arkitekt.

ARKITEKTURA SHEKULLIT TË XX NË SHQIPËRI

Atelieja e Diplomës synon të hedh dritë mbi një temë te një interesi të madh në ditët e sotme në lidhje me trashëgiminë e shekullit te XX ne vendin

tone.

Hulumtimi përqendrohet ne analizimin e rasteve të ndryshme te tipologjisë së arkitekturës totalitare të ndërtuara në Shqipëri. Historia e aktiviteteve te projektimit dhe ndërtimit që kontribuojnë në formimin dhe transformimin e mjedisit, në lidhje me kornizën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të epokave të ndryshme dhe në marrëdhëniet në mes të qytetërimeve të ndryshme. Në veçanti, aspektet në lidhje me përfaqësimin e hapësirës arkitektonike, teknikat, materialet e ndërtimit dhe organizimin e sheshit të ndërtimit; historia e mendimit dhe teoritë mbi arkitekturën dhe qytetin; studimi kritik i veprës arkitektonike, i shqyrtuar në kontekstin e saj duke iu referuar shkaqeve, programeve dhe përdorimit, në modalitetet e saj gjuhësore dhe teknike, në realitetin e saj ekonomik dhe material dhe në kuptimet e saj kulturore.

Temat e kërkimit mund te përfshijnë një nga fashat kohore:

1. Arkitektura në periudhën 1924-1939
2. Arkitektura në periudhën 1939-1944
3. Arkitektura në periudhën 1945-1990
4. Arkitektura në periudhën e tranzicionit mbas vitit 1990.

Drejtimet e projektit kërkimor:

- Analizimi se si zhvillimi i arkitekturës së ndërtuar në Shqipëri u ndikua nga ideologjia e kohës dhe se si u mbështet dhe zhvillua nga arkitektët.
- Hulumtimi në arkivat e ndërtimit, përshkrimi dhe prezantimi i projekteve origjinale të projektimit të arkitekturës totalitare sipas periudhave.
- Hulumtimi në terren dhe analizimi i objekteve të ndërtuara.
- Evidentimi i vlerave, ruajtja dhe rehabilitimi i tyre.

PROJEKTIMI I QËNDRUESHËM DHE RINDËRTIMI NE RAST TE FATKEQËSIVE NATYRORE

Atelieja e Diplomës synon të trajtojë çështjen e projektimit të qëndrueshëm dhe rindërtimit në rast te fatkeqësive natyrore.

Katastrofat mund të jetë katalizator për ndryshime pozitive. Gama e rreziqeve mjedisore përfshin fenomene gjeofizike si tërmete, rrëshqitje toke, përmytje të shpejta, tsunami dhe shpërthime vullkanike; katastrofat teknologjike që përfshijnë aksidente kimike dhe derdhje; dhe problemet mjedisore që zgjasin ne kohe (p.sh., thatësira, erozioni dhe ndryshimi i klimës).

Historia ka demonstruar se katastrofat u kanë dhënë disa qyteteve një shesh të zbrazët për të rindërtuar sipas një plani më të qëndrueshëm: Çikago pas Zjarrit të Madh, Halifax pas Shpërthimit ose Varshavë pas Luftës së Dytë Botërore. Fatkeqësitë natyrore mund të ofrojnë këtë lloj mundësie. Megjithatë, në panik dhe dëshpërim pas një fatkeqësie natyrore, ka një presion për të vepruar sesa për të reflektuar. Planifikimi strategjik shpesh i lëshon vendin veprimit të fragmentuar. Projektet e rindërtimit shpesh arrijnë vetëm të rikthejnë status quo-në, në vend që ta përmirësojnë atë.

Atelieja e Diplomës synon ne fitimin e një rruge projektimi resiliante¹ dhe te qëndrueshëm te arkitekturës për t'iu përgjigjur katastrofave dhe fatkeqësive natyrore dhe atyre të bëra nga njeriu - si dhe ndryshimeve afatgjata që rezultojnë nga ndryshimi i klimës. Një qasje e qëndrueshme për projektin e rindërtimit pas katastrofës duhet të adresojë jo vetëm nevojat e mjedisit të ndërtuar, por edhe ekosistemin, kërkesat socio / kulturore dhe të infrastrukturës. Miratimi i këtij kuadri siguron që rindërtimi të mos ketë ndikim negativ në aspektet e tjera të shëndetit dhe mirëqenies afatgjatë të rajonit. Ruajtja e një ekuilibri delikat te projektit midis qëllimeve natyrore dhe sociale/ekonomike do të sigurojë gjithashtu që komunitetet të koordinojnë burimet e disponueshme dhe të mbajnë mundësi të drejta dhe të barabarta për të gjithë aktorët në procesin e rindërtimit.

PROJEKTIMI I BANESAVE

Atelieja e Diplomës synon të trajtojë çështjen e projektimit të qëndrueshëm te banesave. Qëllimi i Ateliese është të mësojë rreth strategjive kryesore të projektimit që kërkohen për të zhvilluar strehimin dhe mjediset gjithëpërfshirëse të banesave për zhvillim të qëndrueshëm urban. Atelieja e Diplomës synon kuptimin e rëndësisë se hulumtimit të tipologjisë së banesave kolektive dhe potencialeve te metodologjisë se projektimit te tyre. Me këto lloje ndërtesash që evoluojnë ne vetvete si dhe për shkak të kushteve specifike te vendit, propozimet e projektit do të kenë ne konsiderate lidhjen me territorin, tipologjinë e saj urban, kontekstin historik dhe ekonomik, dendësinë dhe programet e saj.

Projektet rezidenciale mund të duken shumë të lehta për t'u kuptuar dhe projektuar, por llojet e ndryshme të rezidencave që përdoren sot dhe grupet e ndryshme të përdoruesve ndaj të cilave synohen e bëjnë atë një temë të gjerë, diçka që kërkon sasi të mëdha kërkimi për t'u projektuar.

Temat e kërkimit mund te përfshijnë:

1. Ndërtesat me përdorim të përzier

Me pandeminë globale që i detyron njerëzit të qëndrojnë të mbyllur në shtëpitë e tyre, zhvillimi i ndërtesave me përdorim të përzier me hapësira banimi, tregtare dhe zyra të gjitha në një vend do të ndihmojë në rrethana të ngjashme në të ardhmen. Një student duhet të bëjë kërkime të gjera se si të kombinohen siç duhet të gjitha vendet e ndryshme dhe qëllimet që ato shërbejnë për të krijuar një ndërtesë që përmbush funksionalitetin dhe është gjithashtu estetikisht e këndshme.

Ndërtesat me përdorim të përzier si temë e tezës do të ndihmojnë një student kur të fillojë të punojë për shkak të potencialit të tij të madh si një prirje e ardhshme në arkitekturë.

¹ Projektimi resiliant është një qasje e re ndaj projektimit, ndërtimit dhe funksionimit të ndërtesave. Qëllimi i tij është të krijojë struktura që i rezistojnë katastrofave natyrore dhe të bëra nga njerëzit, si dhe të sigurojnë rindërtim të shpejtë.

2. Strehimi vertikal

Me rritjen e popullsisë dhe uljen e disponueshmërisë së tokës së lire, strehimi vertikal është një nga zgjidhjet më të mira në dispozicion për të trajtuar kërkesat e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm. Strehimi vertikal është ndërtesa banimi ku arkitektët rregullojnë hapësira vertikalisht në vend të horizontale, për të krijuar më shumë njësi në një gjurmë më të vogël. Këto ndërtesa përmbajnë gjithashtu zona komunitare dhe hapësira të gjelbra të ndërthurura me njësitë e banimit për të inkurajuar njerëzit të jenë më socialë dhe të mos qëndrojnë të mbyllur në apartamentet e tyre të larta.

3. Shtëpitë me rresht

Shtëpitë me rresht përkufizohen si një seri shtëpish të lidhura përmes mureve anësore të përbashkëta. Ato janë një mënyrë e shkëlqyer për të ndërtuar shtëpi individuale në zona më të vogla dhe me materiale më të pakta, duke i bërë ato më të lira. Shtëpitë me rreshta mund të jenë tashmë në përdorim në Shtetet e Bashkuara dhe vendet evropiane, por ato kanë potencial të madh në vendet e botës së tretë dhe në vendin tone ne zonat ku ka një problem të vështirë hapësinor.